



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.40/2018

Prishtinë, më 19 dhjetor 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mirjeta Kalludra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Saranda Bogujevci, Shemsi Sylja dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Sasha Milosavljeviq, Mexhide Mjaku-Topalli, Fisnik Ismaili dhe Veton Berisha.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Jahja Lluka-këshilltar i kryeministrit, Prenk Gjetaj-ZKM-KQPZH, Kushtrim Gara- ZKM-KQPZH, Teuta Prekazi-UN HUMAN RIGHTS, Hajrudin Skenderi-Sëiss Embassy, Festina Veselaj-OJQ HANDIKOS, Emine Jakupi-GP LDK, Besiana Dauti- Ekonomia Online, Zana Ulaj, praktikante, Kuvendi i Kosovës, Donika Bekteshi-KDI, Andin Hoti-Deputet dhe Emnesa Zhubi-Ridea.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë.

Rend dite:

- 1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;**
- 2. Diskutim në Komisionin Funkcional lidhur me nënshkrimin e planit të Përbashkët rajonal në Hagë, për persona të zhdukur, i lansuar nga Komiteti Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (KNPZH). Të ftuar; Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara

Kryetarja, konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 4 tetor, 8 tetor, 12 nëntor dhe 14 nëntor 2018, u miratuan pa vërejtje.

2. Diskutim në Komisionin FunkSIONAL lidhur me nënshkrimin e planit të Përbashkët rajonal në Hagë, për persona të zhdukur, i lansuar nga Komiteti Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (KNPZH). Të ftuar; Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur

Kryetarja tha se jeni të ftuar për të raportuar lidhur me nënshkrimin e planit të përbashkët rajonal në Hagë, për persona të zhdukur, në mënyrë që ta na njoftoni me shumë rreth këtij plani.

Jahja Lluka tha se plani kornizë ka 5 shtylla të rëndësishme të cilat janë për t'u implementuar për zbardhjen e fatit për personat e zhdukur, plani kornizë është nënshkruar si shtet i barabartë me shtetet e tjera, ka pasur reagime nga Serbia pas nënshkrimit të marrëveshjes, mirëpo në pjesën zyrtare nuk ka pasur asnjë gjë. Ne kemi vazhduar me punën pas nënshkrimit të planit kornizë në Hagë, kemi pasur një takim rajonal në Mal të Zi, ku është bërë një plan 3 vjeçar dhe jemi të gatshëm të punojmë. Ne, si komision, qeveritar jemi në ngritje të kapaciteteve tona, kemi një marrëveshje me Komitetin Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, që shumë shpejt të krijojmë një ekip për trajnime për data bazë dhe për çështje të tjera të cilat janë shumë të rëndësishme, po ashtu jemi shumë aktiv edhe në takimet rajonale. Edhe familjarët janë aktiv, mirëpo në një pjesë duhet thënë se kemi probleme në çështjen e familjarëve për arsye se organizimet rajonale organizohen nga një organizatë në Bosnje, e cila Kosovën nuk e pranon. Është mirë që edhe në planin të cilin po e përgatisim eventualisht për një kontratë me Serbinë të zë vend të duhur çështja për personat e zhdukur dhe në këtë plan kemi kërkuar edhe ngritjen e kapaciteteve të Komisionit Qeveritar.

Shpresojmë që do të kemi përkrahjen e Qeverisë, ashtu siç e kemi pasur deri më tani, sepse kemi nevojë për shumë njerëz profesionistë.

Gjatë vizitës në Kosovë princi Charls, i ka pritur familjarët edhe gjatë samitit të Londrës dhe është vazhdimisht në angazhim e sipër. Ne jemi në kontakt me princin Charls, shpresojmë që ai do të angazhohet edhe më tutje. Qeveria e Kosovës është munduar për pjesën e tyre të punës të merret edhe me rehabilitimin e familjeve dhe ndihmën e shoqatave të cilat merren me çështjen e familjarëve, kemi ndarë një ndihmë modeste 25.000 euro për organizatat e regjistruara.

Në Institutin e Mjekësisë Ligjore kemi pasur shumë probleme, për një kohë të gjatë nuk ka pasur drejtor. Kemi kërkuar vendimin nga drejtori i institutit të mjekësisë ligjore që të bëjë një plan detal për funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore, në murgun e Prishtinës kemi shumë probleme meqenëse aty ka shumë mbetje mortore, ku një pjesë e këtyre mbetjeve nuk kanë të bëjnë me luftën.

Kryetarja pyeti se pas nënshkrimit të planit kornizë, cili është hapi i parë, ju si komision për vitin 2019 keni planifikuar diçka konkrete mes Kosovës dhe Serbisë, për personat e zhdukur.

Lirije Kajtazi, duam të kemi më shumë informacion për mënyrën e zbatimit dhe të raportimit si do të bëhet në vijim dhe çka do të mendonit për takimet dhe keqkuptimet mes zonjës Mogerini dhe kryeministrit e Kosovës, sa do të kishte mundësi që të insistohet më tepër në çështjen e të pagjeturve, kjo çështje ka të bëjë edhe me karakterin e luftës dhe me detyrimet e padrejta, dhe nuk është thjesht një fshehje e njerëzve, por ka të bëjë me aparat dhune i cili ka ushtruar terror këtu dhe vazhdon lojën politike me të pagjeturit. Do të është me interes që të ndalemi në këtë pikë në mënyre që të shihet qartazi se kush është dhe çfarë ka bërë Serbia për të parë edhe detyrimet që i dalin Kosovës në hapat e tjerë të bashkëpunimit, qoftë ekonomik apo formave të tjera.

Saranda Bogujevci, ka qenë një marrëveshje në mes të Komitetit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur dhe UNMIK-ut që me vonë është përcjellë te EULEX-i, çka po ndodh tani me këtë marrëveshje? Sa i përket direkt një marrëveshje në mes të Kosovës dhe ICMP-së, a është përcjellë në këto instanca dhe a është duke u diskutuar rreth kësaj, a është ndonjë plan konkret në përcjellje të dhënave që i ka EULEX-i, qoftë te Komisioni Qeveritar apo te institucionet përkatëse. Cilat kanë qenë kërkesat e Kroacisë që nuk është nënshkruar marrëveshja në Londër, cili ka qenë raporti mes Kroacisë në këtë rast që lidhet direkt me Serbinë dhe në bazë të këtyre kërkesave, a ka qenë në interes tonin? A ka një trup mbikëqyrës sa i përket marrëveshjes, çka përmban plani 3 vjeçar, a është plan që mbahet brenda komisionit qeveritar në përputhje me komisionet e tjera rajonale, apo është plan i përbashkët? Sa i përket incizimit nga Kombet e Bashkuara nga kush është kërkuar ky raport dhe a vjen ky raport direkt te Komisioni Qeveritar? A ka ndonjë program specifik sa i përket rehabilitimit të familjarëve dhe cili departament është përgjegjës për këtë, për shkak se nëse flitet për rehabilitim, kemi fusha të ndryshme të nevojave që familjarët i kanë, nga cili departament ndahen mjetet financiare për organizatat, a ndërlidhet me Komisionin Qeveritar për personat e pagjetur apo është një departament tjetër që merret me këtë çështje?

Shemsi Sylja theksoi se e konsideron zbardhjen e fatitë personave të pagjetur, si një çështje që po zvarritet, ndërsa pyeti se a është bërë mjaft në këtë drejtim, si nuk u ngrit zëri për këtë çështje?

Teuta Haxhiu pyeti a i merrni me vete ato dokumente, që t'i bëni presion edhe mekanizmave ndërkombëtarë, numri prej 1647 persona të pagjetur është shqetësues. A mundet secili qytetar ta gjejë këtë datë bazë, a i keni të publikuara të gjitha të dhënat? Prej mandatit të parë kam kërkuar plotësim- ndryshimin e ligjit, kam të gjitha materialet që këto organizata qysh në atë kohë dhe familjarët e të pagjeturve kanë kërkuar këtë plotësim ndryshim, sepse ne nuk mund t'i rehabilitojmë familjarët e të pagjeturve pa ndryshuar ligji. Kjo është kërkesa e parë e familjarëve pas zbardhjes së fatit të pagjeturve kur të sillet ligji në Kuvend.

Andin Hoti tha se bashkërisht e kemi votuar një rezolutë në maj të këtij viti me mbi 77 vota dhe është cekur dhe kam thënë që nuk do të votojë asnjë marrëveshje me dialogun me Serbinë pa u diskutuar çështja e të pagjeturve në Bruksel.

Luljeta Veselaj-Gutaj tha se në qoftë se nuk zbatohet plani kornizë cilat janë masat disiplinore dhe kush e monitoron zbatimin e këtij plani kornizë? Si do t'i ngitni kapacitetet dhe çka prisni pas ngritjes së kapaciteteve të Komisionit Qeveritar. Kemi vetëm një prokuror që merret me çështjen e të pagjeturve dhe duhet ta ngrisim zërin edhe ju, si Komision Qeveritar dhe ne si

deputetë që të ngritën kapacitete që merren me çështjen e prokurorisë lidhur me çështjen e të pagjeturve.

Veton Berisha, parashtrori çështjen e personave të zhdukur nga komuniteti egjiptian, a keni informata të sakta për saktësinë e identitetit, sepse kam parë disa publikime që nuk e kanë identitetin e saktë përcaktuar me një identitet tjetër dhe kjo më bënë që të kuptoj se nuk e keni kontaktin e drejtpërdrejtë me familjet. A keni në Komisionin Qeveritar persona nga komuniteti që do të ishte ndihmë për komisionin dhe mendoj që duhet të lëshohemi edhe në këto baza. Në secilin deklaram publik thuhet se ka të vrarë dhe të zhdukur vetëm nga shqiptarët, kjo nuk qëndron, por ka të vrarë edhe të zhdukur edhe nga komuniteti egjiptian, pres nga Komisioni Qeveritar dhe nga mekanizmat e tjerë që të dihen saktë sa persona janë.

Jahja Lluka, tha se plani Serbi - Kosovë është nënshkruar si plan kornizë dhe është plan rajonal. Procesi i Berlinit na ka mundësuar që për herë të parë të jemi si shtet i barabartë në biseda. Bashkimi Evropian nuk ka qenë asnjëherë i interesuar për të hapur këtë çështje, ndërsa me ardhjen e kryeministrit Haradinaj, është dhënë një vend i rëndësishëm për zbardhjen e fatit të zhdukurve. Në planin që jemi duke e punuar si qeveri me delegacionin e Kosovës çështja e të zhdukurve e ka vendin e vet, nuk do të lëshojmë pe në asnjë rast deri sa nuk zgjidhet edhe rasti i fundit. Serbët nuk janë të interesuar, kanë kërkesa për lokacione në Kosovë për persona të zhdukur, mirëpo nëse kërkojnë hapjen e lokacionit në Koshare nuk e kemi asnjë problem.

Kroacia nuk e ka nënshkruar në Londër, sepse Kroacia e trajton vetën në nivel më të lartë se i gjithë rajoni sepse është pjesë e BE- së, tani e kanë pranuar, por nuk kanë probleme me ne as Bosnja, as Mali i Zi, por kanë probleme me serbët ku po kërkojnë hapjen e varrezave ilegale apo të fshehura që ka në Serbi ende. Kërkesa është e njëjtë edhe nga ana jonë. Mbikëqyrja e planit është me siguri nga organizatat ndërkombëtare nga procesi i Berlinit dhe nuk jam i sigurt që dikush do të pësojë ndonjë ndëshkim, jemi në përgatitje të një plani të temave për të cilat duhet të diskutohet dhe të zgjidhen lidhur me Serbinë.

Incizimet kanë qenë iniciativë e Kryqit të Kuq Ndërkombëtarë, i kemi bërë një kërkesë NATO-s, një takim të nivelit më të lartë me përfaqësuesit e NATO-s për të marrë incizimet satelitore nga NATO-ja, mirëpo na është sqaruar që NATO-ja inteligjencë të veten nuk ka, por i ka të shteteve dhe kështu ne duhet të merremi më shumë me shtete.

Kemi një rehabilitim i cili bazohet në shoqatat dhe ka pas rehabilitim nëpër banja por ka nevojë për rehabilitime tjera sepse familjarët kanë trauma dhe do të ishte mirë që edhe MPMS-ja të jetë më aktive në këtë drejtim sepse ata kanë program dhe mjete. Mjetet për rehabilitim ndahen nga buxheti i Kosovës dhe nëpërmjet komisionit u shpërndahen të gjitha shoqatave të regjistruara.

Është shumë vonë 20 vjet, fatkeqësisht as Bashkimi Evropian, por as insistimi jonë si Kosovë nuk ka qenë që ky problem të zgjidhet.

Rezoluta për ne është obligative. E kemi krijuar grupin punues për ndryshimin e ligjit për persona të zhdukur dhe nuk mund të caktoj datën se kur do ta sjellim, meqenëse ligji e ka edhe një problem tjetër, jemi tani në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ata janë duke punuar në pjesën e ligjit për skemat pensionale, nëse ky ligj nuk adaptohet me ligjin për të zhdukurit ne nuk kemi bërë asgjë.

Jahja Lluka njoftoi tha se jemi duke punuar për një punë të rëndësishme të ruajtjes së rrobave që kanë qenë në Institut të mjekësisë ligjore jemi duke i vendosur në një vend të posaçëm të përkohshëm, kur të përfundojmë javën tjetër vendosjen e rrobave në atë vend të jeni edhe ju prezent së bashku me familjarët, sepse na ndihmoni edhe neve edhe familjarëve, dhe u akorduar që për çdo takim t'ju raportojmë me shkrim Komisionin Parlamentar dhe për çdo kërkesë të tuajën jemi të gatshëm të ju përgjigjemi.

Kushtrim Gara tha se sa i përket rritjes së transparencës të fillojmë vitin e ardhshëm edhe me funksionalizimin e një web- faqeje të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, kjo ka qenë edhe një pikë e rezolutës së Kuvendit për rritjen e transparencës.

Teuta Haxhiu pyeti se a ka familjar që nuk kanë pranuar të japin gjak lidhur me testin e ADN-së.

Kushtrim Gara, tha se ka raste kur familjarët nuk kanë dhënë gjak dhe kjo ka ndodhur nga ana psikologjike e familjarëve me shpresën se familjari i tyre mund të jetë gjallë, por edhe ka raste kur janë manipuluar.

3. Të ndryshme

Saranda Bogujevci, njoftoj anëtarët e komisionit se ka pranuar ftesë nga Ambasada e SHBA-ve për pjesëmarrje në programin për personat e zhdukur nga 14 janar deri më 1 shkurt.

Lirije Kajtazi tha se është një komision i veçantë, i cili po grumbullon dosjet e krimit dhe po i dorëzon në prokurori, ka dorëzuar një numër të madh të dosjeve për të cilat mendoj se është mirë të njoftohemi si komision, dhe është mirë që t'i ftojme në Komision, por se kur të bëhet kjo do të akordohemi me kryetaren.

Me pastaj me insistimin e deputetes Teuta Haxhiu, komisioni vazhdoi mbledhjen me dyer të mbyllura ku u diskutua lidhur me organizatat dhe fondacionet të cilat merren me rehabilitimin e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje